



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.11.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtarit {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 3. Irena Plaku*** (anëtare)
- 4. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 5. Alban Toro*** (anëtar)*
- 6. Marçela Shehu*** (anëtare)
- 7. Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***z. Dritan Hallunaj, znj. Brikena***

Ukperaj, z. Klodian Kurushi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

5. BIRN.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtim i projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtarit {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar kolegë!

Sot është mbledhja e radhës e Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 30.11.2023, ora 11:00.

Ju bëj me dije se Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor është në një angazhim institucional dhe nuk është prezent sot. Gjithashtu nuk është prezent në këtë mbledhje znj. Ukperaj, z. Hallunaj dhe z. Kurushi, për arsye objektive dhe subjektive.

Prezent në sallë është zonja Rupa, zonja Shehu, zonja Luli, zoti Hado, zonja Plaku dhe unë Ilir Rusi, dhe “online” është zoti Toro.

Meqenëse është krijuar kuorumi i nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sipas rendit të ditës kemi çështje të cilat shqyrtohen me dyer të hapura, “online”, dhe çështje të mbyllura.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës meqenëse u krijua kuorumi, prezent në sallë 6 dhe 1 anëtar “online”, zoti Toro. Pika e parë është shqyrtimi i projektvendimit

“Për dhënie leje të papaguar gjyqtarit {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores znj. Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur relacionin për miratimin e projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtarit {...}”, i cili u është dërguar anëtarëve më parë dhe janë njohur.

Më datë 03.11.2023 z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka paraqitur kërkesë për leje të papaguar për një periudhë më pak se dymujore, konkretisht nga data 07.12.2023-26.01.2024, protokolluar në Këshill në datë 03.11.2023.

Në kërkesë ka parashtruar arsyet familjare për të cilën ka kërkuar lejen e papaguar, për shkak se bashkëshortja e tij e cila ndër të tjera është gjyqtare, ka marrë lejen e lindjes dhe ka udhëtuar së bashku me dy fëmijët e tjerë në Shtetet e Bashkuara, në pritje të lindjes së fëmijës së tyre. Në këto kushte ai ka paraqitur kërkesën për të përfituar leje të papaguar për arsye familjare.

Me qëllim trajtimin e kërkesës, duke iu referuar parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 72/2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, është kërkuar informacion zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe nga ana e tij është dërguar mendimi. Në mendimin e tij zëvendëskryetari ka shprehur mendimin se leja e papaguar e kërkuar nga gjyqtari nga data 07.12.2023-26.01.2024 për arsye familjare, nuk cenon funksionalitetin e gjykatës, pasi nga data 15 dhjetor deri në datën 15 janar është parashikuar procesi i mbartjes vjetore të dosjeve. Gjyqtarët gjatë kësaj periudhe rekomandohen që të mos zhvillojnë procese gjyqësore me përjashtim të rasteve të cilat vlerësohen të ngutshme nga ana e gjyqtarëve.

Sa i përket ngarkesës aktuale të gjyqtarit {...} si dhe gjyqtarëve të tjerë, sipas të dhënave të dërguara nga kancelarja e gjykatës nëpërmjet postës elektronike më datë

07.11.2023, rezulton se:

- Gjyqtari ka në shqyrtim 108 çështje.
- Ngarkesa mesatare aktuale e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është rreth 221 çështje.

Në fakt këto të dhëna deri në muajin shtator, pra nuk janë përfshirë gjyqtarët të cilët janë emëruar në tetor të vitit 2023 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (konkretisht katër gjyqtarët e tjerë).

Nga informacioni i marrë nga dosja personale, rezulton se gjyqtar z. {...} ka një eksperiencë prej 13 vitesh si gjyqtar. Është caktuar në datën 21.12.2011 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me vendim nr. 404, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar në skemë delegimi, ku ka ushtruar funksionin deri në datën 01.02.2023 për shkak të ndërprerjes së skemës së delegimit.

Nga data 01.02.2023 është rikthyer pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Lidhur me lejen e papaguar, në nenin 24 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin” është parashikuar se magjistrati mund të përfitojë leje prindërore ose pushime të tjera. Në këtë nen parashikohen disa kriteret për dhënien e lejes së papaguar nga Këshilli dhe njëkohësisht parashikohet se: “Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar.”

Në bazë të këtij parashikimi, Këshilli ka miratuar vendimin nr.72, datë 20.05.2019 për “Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, në të cilin përcaktohen kriteret dhe procedura e dhënies së lejeve.

Sa i përket llojit të lejeve të papaguara që jepen nga Këshilli:

- a. Leje prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues;
- c. Leje për arsye familjare ose shëndetësore;

Në këtë rast, gjyqtari z. {...} ka kërkuar leje për arsye familjare.

Lidhur me kushtet për dhënien e lejes për arsye familjare:

... 8. Leja për arsye familjare dhe/ose shëndetësore për një periudhë nga 30 ditë deri në 2 vjet. Gjyqtari në rastin konkret kërkon leje për një periudhë më pak se 2 muaj.

Kërkesa e gjyqtarit trajtohet nga Komisioni, i cili brenda 7 ditëve i përcjell mbledhjes propozimet për miratimin ose refuzimin e lejes.

Kjo leje mund të jepet e gjitha njëherësh, ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së gjyqtarit, por jo më shumë se 2 vjet.

Siç e thamë gjyqtari ka kërkuar një leje për një periudhë 1 muaj e 19 ditë, nga data 07.12.2023 – 26.01.2024;

Kërkesa është paraqitur më shumë se 30 ditë përpara miratimit të saj.

Gjithashtu është përcaktuar kohëzgjatja e lejes.

Kërkesa e gjyqtarit është shoqëruar me dokumentacion justifikues. Është paraqitur bileta e avionit, gjithashtu është marrë informacion dhe nga kryetari i gjykatës, ku rezulton se gjyqtari ka një ngarkesë prej 108 çështjesh.

Për sa më sipër Komisioni vlerëson se kërkesa e gjyqtarit për leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë më pak se dymujore, përmbush kriteret e përcaktuara në neni 24 si dhe vendimin nr.72/2019; arsyeja për këtë leje, e paraqitur nga gjyqtari, është e pranueshme; mungesa e gjyqtarit në ushtrimin e funksionit të tij pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për shkak të ngarkesës që ka ai si gjyqtar dhe e gjithë gjykata në tërësi, nuk vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.

Sa i përket çështjeve gjyqësore të cilat gjyqtari ka në shqyrtim, në kreun VII, pika 8, shkronja ç) të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019, të KLGJ-së, parashikohet se: Në vendimin për dhënien e lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short të çështjeve të gjyqtarit”. Në këtë kuadër KVEVP-ja vlerëson se çështjet që gjyqtari ka në shqyrtim ditën e fillimit të lejes së papaguar, duhet t’i mbeten atij për shkak të periudhës së shkurtër për të cilën kërkohet leja e papaguar. Gjithashtu edhe Zv/kryetari i gjykatës ka shprehur mendimin se çështjet nuk duhet të shqyrtohen edhe për faktin se për gati një periudhë njëmujore gjyqtarët e tjerë do të përjashtohen nga shorti dhe rekomandohen të mos kryejnë gjyqe gjatë periudhës së mbartjes. Referuar të dhënave statistikore të përcjella nga kancelarja e gjykatës, rezulton se ato përfshijnë ngarkesën e

gjqtarëve për tremujorin korrik – shtator 2023, të cilat i janë raportuar KLGJ. Në këto të dhëna nuk përfshihen 4 gjyqtarët e rinj të caktuar në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në datën 19.10.2023.

Lidhur me parashikimet e nenit 25, pika 3, shkronja d) të Ligjit 98/2016, ku rindarja e çështjeve me short lejohet kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara, bazuar sa më lart, duke qenë se koha e lejes së papaguar është shumë e shkurtër dhe ngarkesa e gjyqtarëve më të vjetër në detyrë është shumë e lartë, rekomandohet që dosjet e gjyqtarit të mos rishortohen.

Sa i përket përjashtimit të gjyqtarit {...} nga procedurat e shortimit të dosjeve që regjistrohen në gjykatë, gjatë periudhës së lejes së papaguar, në kreun V, pika 2, të vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore” të Këshillit të Lartë Gjyqësor parashikohet se: “Kryetari i Gjykatës, pas kërkesës së motivuar të gjyqtarit, mund të përjashtojë nga shorti pjesërisht apo tërësisht gjyqtarin, gjatë lejes së papaguar, me afat deri në 30 ditë. Në këto raste kryetari disponon me vendim të arsyetuar”. Pra sipas kësaj dispozite, është kryetari ai që vendos përjashtimin e gjyqtarit nga shortimi i çështjeve që regjistrohen në gjykatë bazuar në kërkesën e motivuar të gjyqtarit, por deri në një periudhë deri në një muaj. Në këto kushte, parasysh faktin se koha e lejes së papaguar është më e gjatë se një muaj, si dhe duke marrë parasysh ngarkesën e gjyqtarëve të tjerë, ku gjyqtarët e caktuar së fundmi normalisht kanë një ngarkesë më të ulët, nga KVEVP-ja vlerësohet se gjatë periudhës së lejes së paguar gjyqtari duhet të përjashtohet tërësisht nga procedura e shortimi i çështjeve gjyqësore. Përjashtimi i tij nga procedura e shortit nuk cenon parimin e barazisë së shpërndarjes së çështjeve si dhe efikasitetin e drejtësisë në aspektin e respektimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit.

Referuar sa më sipër i propozojmë mbledhjes plenare:

1. Miratimin e kërkesës së gjyqtarit {...}, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare, për një periudhë më pak se dymujore, nga data 07.12.2023 – 26.01.2024.
2. Përjashtimin tërësisht nga shorti i gjyqtarit {...}, për periudhën nga data 07.12.2023- 26.01.2024.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord (ripërsëritet).

Yllka Rupa: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për dhënie leje të papaguar gjyqtarit {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e kërkesës të z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare, për periudhën nga data 07.12.2023 – 26.01.2024.

2. Përfundimin tërësisht nga shorti i gjyqtarit {...}, gjatë periudhës së lejes së papaguar, nga data 07.12.2023- 26.01.2024.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të

Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.11.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”, (nuk ka kundërshtime) (relatore znj.Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 3. Irena Plaku*** (anëtare)
- 4. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 5. Alban Toro*** (anëtar)*
- 6. Marçela Shehu*** (anëtare)
- 7. Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***z. Dritan Hallunaj, znj. Brikena***

Ukperaj, z. Klodian Kurushi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. BIRN.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, (nuk ka kundërshtime) (relatore znj.Yllka Rupa).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 2 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, për të cilin është përgatitur relacioni nga zonja Rupa. Për më tej fjalën zonjës Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë.

Gjyqtarja {...} është gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vlerësohet për vitin 01.01.2022 – 31.12.2022. Unë do të paraqes në cilësinë e relatores projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional. Në projektraport është e pasqyruar në mënyrë të plotë procedura e ndjekur. Gjyqtarja është njoftuar lidhur me rezultatin e projektvendimit dhe ka konfirmuar që nuk ka kundërshtime lidhur me projektraportin e vlerësimit. Kështu që unë do të prezantoj në mënyrë të përmbledhur nivelin e vlerësimit dhe pikëizmit për gjithsecilin nga katër kriteret në bazën e të cilit vlerësohet gjyqtarja.

1. Aftësitë profesionale. 1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin

e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës të qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, duke i integruar dhe me një analizë të detajuar të provave. Evidentohet aftësia e gjyqtarës në lidhje me identifikimin dhe përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material. Lidhur me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit “shumë i lartë”, pikëzimi 25 pikë.

1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja {...} ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetimin e vendimeve dhe mbështesin argumentet e gjyqtarës lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Për sa i takon I-B Arsyetimi ligjor, I-B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit. Evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të mirë edhe në lidhje me arsyetimin ligjor në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Kështu që propozohet niveli i vlerësimit “shumë i lartë”, pikëzimi 15 pikë.

I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit gjyqësor në tërësi, nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse, ligji i zbatueshëm, vlerësimi i gjykatës dhe përfundimet e arritura nga gjyqtarja. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi të vendimit të jenë vendosur titujt përkatës, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit. Propozohet niveli i vlerësimit “shumë i lartë”, pikëzimi 10 pikë.

I-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik - në vendimet gjyqësore të analizuara, analiza ligjore si në lidhje me aspektet procedurale të zhvillimit të gjykimit, mënyrën e marrjes së provave apo vlerësimin e atyre, ashtu edhe në analizën ligjore të veprës penale ose objektit të kërkesës penale në shqyrtim, është një analizë e plotë, gjithëpërfshirëse dhe shteruese. Edhe lidhur me këtë komponent gjyqtarja propozohet të vlerësohet në nivelin shumë të lartë, pikëzimi 25 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares” propozohet të jetë pikët 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Për të kaluar tek kriteri tjetër 2. Aftësitë organizative të gjyqtares të cilët vlerësohen në aspektin e 2.A.a Respektimit të afateve ligjore dhe të Kryerjes së procedurave gjyqësore.

Lidhur me 2.A.a Respektimin e afateve ligjore, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka gjykuar në total 162 çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor dhe 320 çështje me afat standard minimal. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (gjithsej 39 çështje), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat ligjor (162 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 24% të çështjeve me afat ligjor jashtë këtij afati. Në projektraport paraqitet e gjithë vijimësia e gjykimit të çështjeve, arsyet e tejkallimit të afateve, për shkaqe që nuk varen nga gjyqtarja, po ashtu edhe të dhëna statistikore. Sipas metodologjisë së miratuar nga Këshilli këto të dhëna statistikore duhet të analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje, që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares. Referuar të dhënave, respektimi i këtyre afateve jo gjithmonë ka qenë i varur nga gjyqtarja, konkretisht duke analizuar 39 çështje të cilat rezultojnë se janë gjykuar përtej afatit ligjor, sipas të dhënave nga raporti analitik evidentohet se disa çështje duhet të konsiderohen të gjykuara brenda afatit ligjor, pasi gjyqtarja ka rezultuar në disa raste me raport mjekësor, në disa raste tejkallimi i afateve është i papërfillshëm, nga ana tjetër ngarkesa e gjyqtares ka qenë e lartë duke marrë në konsideratë edhe natyrën e gjykimit të disa çështjeve. Rezulton se pikërisht numri më i madh i çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor janë ato me objekt “Dërgim në gjyq” për të cilat shqyrtimi i tyre brenda afatit ligjore 30-ditor, bëhet objektivisht i pamundur për shkak të ndryshimeve ligjore

konkretisht të K.Pr.Penale në vitin 2021, sipas të cilit gjyqtari i seancës paraprake duhet të ezaurojë të gjitha metodat e njoftimit dhe në rast mosnjoftimi të të pandehurit gjykata disponon me vendim për pezullimin e çështjes për 1 vit sipas parashikimit të K.Pr.Penale. Gjithashtu volumi i madh çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtarja, raportet shëndetësore, muaji gusht është i planifikuar me lejet vjetore të gjyqtarëve, muaji dhjetor festat e fund vitit, e në vijim deri në 15 janar procesit të mbartjes së dosjeve i cili kryhet në mënyrë manuale, bëjnë të pamundur zhvillimin e gjykimeve gjatë kësaj periudhe.

Këto kanë qenë dhe argumentet e parashtruara nga vetë gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës në raportin e vlerësimit të cilat përbëjnë edhe burime vlerësimi për këtë tregues përveç të dhënave statistikore.

Pra në lidhje me sa parashtrova propozoj që në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja të pikëzohet në nivelin e 15 pikëve.

Për të kaluar tek 2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore. Në lidhje me këtë tregues rezulton se raporti mes numrit të çështjeve për të cilat është marrë vendim në tejkallim të standardit minimal kohor (70), me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (320 çështje), rezulton se gjyqtarja ka gjykuar jashtë standardit minimal 21.8% të çështjeve.

Duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit si: raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 21.8%; shkaqeve që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit sikurse është ngarkesa e lartë pasi rezulton se gjyqtarja ka përfunduar gjatë gjithë vitit 2022 gjithsej 482 çështje, nga të cilat 309 çështje themeli, që përkon me 3-fishin e standardit orientues sasior; kam vlerësuar që në lidhje me pikëzimin dhe nivelin e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtarja të jetë në një nivel pikëzimi me 5 pikë, që është dhe pikëzimi maksimal lidhur me këtë tregues.

Për të kaluar tek 2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje. Mbështetur në të njëjtën analizë si për të dy treguesin e mësipërm, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se standardi minimal kohor për secilën kategori. Për këtë arsye, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues duhet të pikëzohet në nivelin e 5 pikëve.

Në lidhje me 2.A.ç Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore - Në total

duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari pavarësisht kohës së caktimit të tyre (539 çështje) me numrin e çështjeve gjyqësore që ka shqyrtuar brenda vitit kalendarik (482 çështje), rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore në total është 89.42%. Duke pasur parasysh përcaktimin e metodologjisë që gjyqtari mund të vlerësohet deri në pikëzimin maksimal nëse ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së caktuar nga Këshilli, dhe rezulton që gjyqtarja {...} ka shqyrtuar brenda një viti kalendarik rreth 3-fishin e standardit minimal të parashikuar nga akti normativ, propozoj nivelin e vlerësimit për këtë tregues me 10 pikë.

Referuar burimeve të vlerësimit lidhur me treguesin 2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të veçantë që të respektojë afatet dhe vetëm në 2 nga 14 kategoritë e çështjeve që ka gjykuar rezulton që ky afat të jetë tejkaluar. Duke pasur parasysh numrin e madh të çështjeve të shqyrtuara nga ana e gjyqtarës pra të gjitha çështjet që janë gjykuar në këtë vit 1030 çështje për gjithë periudhën e vlerësimit, vlerësoj se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë të aftësisë për këtë tregues dhe duhet të vlerësohet maksimalisht.

Në lidhje me 2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore. 2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, referuar burimeve të vlerësimit, konkretisht të dhënave statistikore, rezulton se nuk është gjeneruar numri i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe në mungesë të tyre do t'i referohemi në total 6 (gjashtë) çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar është 2.2 seanca gjyqësore. Po t'i referohemi numrit mesatar të seancave sipas kategorive të çështjeve rezulton se numri mesatar për kategorinë "seancë paraprake" është 1.6 seanca, ndërsa për kategorinë "penale krime" është 3 seanca. Nga ana tjetër rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet, për këtë arsye propozoj që lidhur me këtë tregues gjyqtarja të pikëzohet në nivelin e 15 pikëve.

Në lidhje me 2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet

procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet, duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse dhe shmangur seancat joproductive. Propozohet niveli i vlerësimit “shumë i lartë” për këtë tregues, pikëzimi 20 pikë.

Për sa i takon 2.C Aftësisë së gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore. Në lidhje me treguesin 2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes, propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë pasi në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara, të renditura në mënyrë logjike dhe orientojnë drejt lexuesin për vendndodhje e tyre duke krijuar mundësi për t’u shfrytëzuar me lehtësi.

Në lidhje me 2.C.b Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa e akteve që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës së “letrës së të drejtave” dhe për këtë arsye unë kam propozuar që lidhur me këtë tregues gjyqtarja të pikëzohet në nivelin e 8 pikëve.

Në mënyrë të përmbledhur propozimi për nivelin e vlerësimit lidhur me kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 98.

Pë të kaluar tek kriteri i tretë 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale. Për gjithsecilin nga treguesit e këtij kriteri gjyqtarja është vlerësuar në nivelin maksimal për shkak se lidhur me etikën në punë gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj.

Po ashtu nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që dëshmojnë për ekzistencën e shfaqjes së pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarës.

Gjithashtu, nga analiza e burimeve të vlerësimit nuk konstatohet përdorimi i gjuhës diskriminuese apo tendencë për paragjykimë gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare.

Lidhur me 3.C.b Numrin tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve, është “I papërfillshëm”, kështu që për gjithsecilin për këto tregues gjyqtarja vlerësohet në nivelin e pikëzimit maksimal dhe vlerësimit maksimal. Për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” niveli i vlerësimit propozohet të jetë “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Për të kaluar tek 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në lidhje me 4.A Aftësinë e komunikimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme. Propozohet niveli i vlerësimit “shumë i lartë”, pikëzimi 25.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale gjithashtu propozohet të jetë në nivelin e lartë, pikëzimi 15, pasi gjyqtarja paraqet korrektësi maksimale, duke respektuar dhe mbrojtur të dhënat personale dhe konfidencialitetin e palëve në proces.

Gjithashtu rezulton nga aktet burim vlerësimi aftësia e gjyqtares për të bashkëpunuar si në aspektin e shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta, po ashtu edhe në shkallën e komunikimit dhe të bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi dhe pikëzimi maksimal për të dy treguesit.

Në lidhje me 4.C Gatishmërinë e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, rezulton pjesëmarrja e saj në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese gjithsej në 3 aktivitete të zhvilluara për 6.5 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve të parashikuara nga ligji kështu që propozohet niveli i vlerësimit me 20 pikë lidhur me këtë tregues.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe për trajnimin e gjyqtarëve. Gjithashtu rezulton se subjekti i vlerësimit ka marrë pjesë me cilësinë e lehtësueses për trajnim e gjyqtarëve në aktivitete trajnuese gjithashtu ka udhëhequr dhe 8 kandidatë përgjatë këtij viti (që i përkasin vitit të dytë dhe të tretë të Shkollës së Magjistraturës). Propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë lidhur me këtë tregues.

Gjithashtu rezulton edhe 4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari

ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun. Propozohet niveli i vlerësimit 5 pikë lidhur me këtë tregues.

Në lidhje me 4.C.ç Publikimet ligjore akademike, gjyqtarja ka paraqitur një botim të majit 2022 (është pikërisht periudha kur vlerësohet gjyqtarja), ku rezulton të jetë bashkautore në një publikim ligjor me titull “Përmbledhja e praktikës gjyqësore për drejtësinë penale për të mitur, zbatimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të miturit në gjykata”. Kështu që kam vlerësuar që lidhur me këtë komponent gjyqtarja të vlerësohet me 5 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit të kriterit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” për gjyqtaren të jetë pikët 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi është si më poshtë:

1. Aftësitë profesionale të gjyqtares, 100 pikë, niveli “Shkëlqyeshëm”;
2. Aftësitë organizative të gjyqtares, 98 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”;
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”;
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, niveli “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Vlerësimi i përgjithshëm për gjyqtaren {...} propozohet të jetë niveli “Shkëlqyeshëm”, pikët 398.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.11.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, (i përgatitur nga relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
3. ***Irena Plaku*** (anëtare)
4. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
5. ***Alban Toro*** (anëtar)*
6. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
7. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj.***

Naureda Llagami, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. *Dritan Hallunaj*, znj. *Brikena Ukperaj*, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

5. BIRN.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtim i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, (i përgatitur nga relatore znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 3 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, për të cilin është përgatitur relacioni nga relatore zonja Plaku. Për më tej fjalën zonjës Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po ju parashtoj në mënyrë të përmbledhur relacionin mbi projektvendimin “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit “Për statusin”, ka detyrimin të fillojë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim

përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Ndër gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e vlerësimit është edhe znj. {...}.

Në Këshillin, me shkresën me nr. {...}, datë 14.11.2023, protokolluar me nr. {...} prot, datë 14.11.2023, është dërguar dosja e gjyqtarit {...}, së bashku me aktet e vlerësimit profesional si dhe vendimi nr.700, datë 19.09.2023 ku ka vendosur konfirmimin e tij në detyrë, vendim i cili ka marrë formë të prerë, pasi ndaj tij nuk është ushtruar e drejta e ankimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit, ka rezultuar se z. {...} është emëruar me vendimin nr. {...}, datë 26.05.1995 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Bulqizë deri në datën 27.06.2003, kur është liruar nga detyra e gjyqtarit me vendimin nr. {...}, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Nga data 01.08.2003 – 08.04.2013 dhe nga data 09.05.2013 - 11.09.2013 ai ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Me vendimin nr. {...}, datë 30.06.2014 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ai është emëruar në detyrën e inspektorit në ish-Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë. Me dekretin nr. {...}, datë 21.11.2016 të Presidentit të Republikës, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku vijon të ushtrojë detyrë. Pra ai është caktuar në detyrën e gjyqtarit jashtë periudhës së vlerësimit 2013-2016, të përcaktuar në nenin 171, pika 5 të Ligjit për Statusin.

Sa më sipër rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, z. {...} nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarit, por atë të inspektorit në ish-Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë nga radhët e jogjyqtarëve.

Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, mbështetet në përcaktimet e nenit 171, pika 5 të ligjit ku ndër të tjera përcaktohet se: “5. ... Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e nivelit të vlerësimit”.

Dispozita e mësipërme detyron Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarëve sipas ligjit

“Për statusin”, vetëm nëse në zbatim të ligjit, ky vlerësim është i mundur.

Në nenin 84, të ligjit “Për statusin”, parashikohet se periudhat e vlerësimit janë trevjeçare dhe pesëvjeçare.

“2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve përvojë profesionale profesionale”.

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 është përcaktuar se gjatë periudhës së vlerësimit tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit.

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor si më sipër, rezulton se procedura e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016 nuk mund të fillojë pasi ai nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarit gjatë kësaj periudhe për sa kohë që është caktuar në detyrën e gjyqtarit në nëntor të vitit 2016.

Në zbatim të nenit 41 të K.Pr.Administrative, në lidhje me nenin 171 pika 5 të ligjit “Për statusin”, që të bëhet vlerësimi duhet së pari:

- 1) Gjyqtari të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar;
- 2) Periudha e stazhit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar;
- 3) Koha/periudha e punës si gjyqtar duhet të jetë jo më pak se një vit.

Në rastin konkret me konstatimin paraprakisht të mungesës së kushteve ligjore për fillimin e procedurës së vlerësimit Këshilli duhet të vendosë mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Në referim të analizës së mësipërme, KVEVP-ja propozon miratimin e projektvendimit përkatës, në të cilin është përcaktuar si më poshtë:

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet mosfillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, pasi nuk plotësohen kushtet për fillimin e kësaj procedure, në kushtet kur gjyqtari nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtarit gjatë kësaj periudhe vlerësimi.

Në pikën 2 përcaktohet që një kopje e vendimit për mosfillimin e procedurës së

vlerësimit t'i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 3 parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij akti administrativ individual të Këshillit.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë pas botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për periudhën e vlerësimit 2013-2016, të gjyqtarit Kujtim Vrançi,”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) i gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.11.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimeve nr. 304, datë 14.02.2013 dhe nr. 354, datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
3. ***Irena Plaku*** (anëtare)
4. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
5. ***Alban Toro*** (anëtar)*
6. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
7. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj.***

Naureda Llagami, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. *Dritan Hallunaj*, znj. *Brikena Ukperaj*, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *BIRN.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtim i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimeve nr. 304, datë 14.02.2013 dhe nr. 354, datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Marçela Shehu).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimeve nr. 304, datë 14.02.2013 dhe nr. 354, datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga relatore zonja Shehu. Për më tej fjalën zonja Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Me datë 31.07.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është depozituar shkresa nr. {...} prot., datë 28.07.2023 e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me procedimin disiplinor ndaj magjistratit, z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Nga përmbajtja e saj, rezulton se Këshilli me shkresën nr. {...} prot., datë 30.06.2023 i ka përcjellë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë praktikën dokumentare lidhur me kërkesat për procedim disiplinor të Ministrit të Drejtësisë ndaj magjistratit, z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Pas paraqitjes së kërkesave për nisjen e procedimit disiplinor ndaj magjistratit, z. {...}, Ministri i Drejtësisë ka kërkuar pezullimin e kërkesave. Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 304, datë 14.02.2013 e në vijim me vendimin nr. 354, datë 19.07.2023 ka vendosur pezullimin e kërkesave të Ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit, z. {...}.

Sipas Inspektorit të Lartë i Drejtësisë, pas vendimmarrjes së datës 19.07.2013 nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk është zhvilluar asnjë procedurë apo marrë asnjë vendim në lidhje me kërkesat për nisje të procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}.

Gjithashtu Inspektori parashtron se në rastin konkret edhe KLGJ, si organi që i kanë kaluar funksionet e mëparshme të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk ka zhvilluar asnjë procedurë apo vendimmarrje në lidhje me këtë procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}.

Paraprakisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka vlerësuar se pezullimi i procedimit disiplinor nga ana e ish-Këshillit të lartë të Drejtësisë është një gjendje juridike, që pengon palët të vazhdojnë më tej procedimin disiplinor të filluar deri në rënien e shkakut për të cilin është marrë ky vendim pezullimi. Me pezullimin e procedimit disiplinor, procesi administrativ qëndron në të njëjtën gjendje duke përjashtuar çdo lloj vendimmarrje apo zhvillimi procedure nga ana e subjekteve të tij. Me zhdukjen e rrethanave të cilat kanë diktuar pezullimin e procedimit disiplinor, nuk ekziston më asnjë arsye për mosvijimin e procedimit disiplinor.

Sa sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pretendon se nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi që i kanë kaluar funksionet e mëparshme të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duhet të zhvillohet një proces mbi verifikimin e rënies apo ekzistencës së shkakut të pezullimit, duke vendosur paraprakisht në lidhje me rifillimin ose jo të procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 96/2016, “Për

statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nga aktet e administruara nga ana e Komisionit Disiplinor, rezulton se, me shkresën nr. {...} prot., datë 01.10.2012 Ministri i Drejtësisë ka kërkuar pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë:

1. Nisjen e procedimit disiplinor për magjistratin {...};

2. Më pas Ministri i Drejtësisë i ka parashtruar po ish-KLD-së kërkesën për pezullimin e kërkesave për procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}, me arsyetimin se : “...referuar faktit se, çështja objekt inspektimi është në shqyrtim në Gjykatën e Lartë pas ushtrimit të së drejtës së rekursit nga palët dhe ende nuk ka përfunduar, kërkojmë pezullimin e shqyrtimit të kërkesave për procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}, deri në përfundimin e shqyrtimit në gjykatat më të larta. Kjo kërkesë gjen mbështetje në nenet 1, 2, 3 dhe 23 të Kodit të Procedurave Administrative”. Pra ky ka qenë shkaku i pezullimit të procedimit disiplinor.

Më pas, pas paraqitjes së kësaj kërkesë, ish-KLD ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor ndaj magjistratit deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes objekt procedimi në gjykatat më të larta.

Më pas Ministri i është drejtuar përsëri Këshillit për të vijuar gjendjen e pezullimit. Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka pranuar këtë kërkesë dhe deri më sot çështja (procedimi disiplinor) ka vijuar të jetë e pezulluar.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, të bëra me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 11.08.2016, në nenin 147/a dhe 147/d është parashikuar ngritja si organe kushtetuese e institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në mbështetje të nenit 147/a, shkronja “b” të Kushtetutës, Këshilli i Lartë Gjyqësor është institucioni përgjegjës për të vendosur masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve. Ndërsa në mbështetje të nenit 147/d, pika 1, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha

niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, etj.

Gjithashtu në referim të nenit 172 “Dispozita kalimtare për procedimet disiplinore”, të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: “Hetimet disiplinore të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nga Ministria e Drejtësisë, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe inspektorët në Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme përfundohen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas dispozitave në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij ligji.[...]... Procedimet disiplinore të papërfunduara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ose në Prokurorinë e Përgjithshme në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kryhen brenda afatit 6-mujor pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Organet përgjegjëse, sipas nenit 160, të këtij ligji, zbatojnë rregullat procedurale të parashikuara në këtë ligj[...]... Për shkeljet disiplinore të parashikuara sipas këtij ligji, që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të tij, dhe që parashikoheshin si të tilla në kohën e kryerjes së tyre, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të parashikimeve të pikave 1 dhe 2 të këtij neni[...]... Organet kompetente për procedimin disiplinor zbatojnë parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm për magjistratin që ka kryer shkeljen disiplinore.”

Në analizë të këtyre dispozitave ligjore, konstatohet se fryma që përshkon dispozitat me karakter kalimtar është vazhdimësia institucionale dhe e ushtrimit të funksioneve nga organet e mëparshme të Institucioni i Këshilli të Lartë Gjyqësor dhe i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Parimi i vazhdimësisë ligjore dhe institucionale, është thelbi mbi të cilin çdo organ kushtetues ose i krijuar me ligj ushtron pushtetin, në rastet kur legjislacioni i ri ndryshon funksionin dhe kompetencat e organit ekzistues.

Nga ana e dispozitave ligjore me karakter kalimtar janë trajtuar në mënyrë të hollësishme një sërë çështjesh të cilat kanë të bëjnë me: (i) kompetencat dhe mënyrën e ushtrimit të tyre nga ana e organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (ii) momentin e krijimit të institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (iii) transferimin e dosjeve, etj.

Sa sipër, nga ana e Komisionit Disiplinor u verifikuan kushtet në lidhje me ekzistencën e shkakut të pezullimit të procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}.

Nga informacioni i ardhur nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, rezulton se:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari {...}, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e Shoqërisë Tregtare “Kërçuku”sh.p.k etj. me objekt sigurimin e padisë dhe pezullimin e veprimeve përmbarimore, me vendimin e ndërmjetëm datë 25.05.2012 ka vendosur: Pranimin e saj. Ndaj këtij vendimi është ushtruar e drejta e ankimit. Ish Gjykata e Apelit Durrës, pasi ka shqyrtuar çështjen, ka vendosur: Ndryshimin e këtij vendimi. Nga palët ndërgjyqëse është ushtruar e drejta e rekursit në Gjykatën e Lartë, duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit, si dhe duke kërkuar pezullimin e këtij vendimi.

Gjykata e Lartë pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, me vendimin e saj nr. 481, ka vendosur: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 136, datë 30.10.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës.

Gjykata e Lartë pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e ushtruar ndaj vendimit nr. 1570 (136) të Gjykatës së Apelit Durrës, në dhomë këshillimi, përveç pezullimit, me vendimin e saj nr. 406, datë 19.02.2016 ka vendosur: Mospranimin e rekursit të paraqitur nga paditësit Shoqëria “x”. Ky ishte vendimi i cili përbën edhe momentin e rënies së shkakut të pezullimit të procedimit disiplinor.

Ndërkohë, shqyrtimi i padisë në themel ka përfunduar nga një tjetër trup gjykues, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. 3423, datë 28.12.2012, duke u vendosur pranimi i padisë pjesërisht. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

Në kushtet kur tashmë shkakut i pezullimit të procedimit disiplinor, konsideruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vendimet e tij nr. 304, datë 14.02.2013 dhe nr. 354, datë 19.07.2013 për “Pezullimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatat më të larta”, ka rënë dhe nuk ekziston më, nga Komisioni Disiplinor vlerësohet se jemi në kushtet e shfuqizimit të vendimeve të pezullimit. Gjithashtu, me rënien e shkakut të pezullimit dhe shfuqizimin e vendimeve përkatëse rezulton se tashmë nuk ekziston asnjë shkak që të pengojë shqyrtimin e

kërkesës për procedim disiplinor.

Sa sipër, Komisioni Disiplinor në mbledhjen e datës 23.11.2023, vendosi t'i parashtrijë mbledhjes plenare projektvendimin për shfuqizimin e vendimeve nr. 304, datë 14.02.2013 dhe nr. 354, datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për "Pezullimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}...".

Ky projektvendim është i strukturuar si më poshtë:

Në pikën e parë të projektvendimit propozohet shfuqizimi i vendimeve nr. 304, datë 14.02.2013 dhe nr. 354, datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për "Pezullimin e procedimit disiplinor...".

Në pikën e dytë të projektvendimit është parashikuar propozimi për vijimin e shqyrtimit të kërkesës për procedimin disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Durrësit dhe dërgimin e akteve Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në pikën e tretë të projektvendimit është përcaktuar njoftimi i vendimit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky është projekt-akti që Komisioni Disiplinor i paraqet sot për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për shfuqizimin e vendimeve nr. 304, datë 14.02.2013 dhe nr. 354, datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin e procedimit disiplinor

ndaj magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Shfuqizimin e vendimeve nr. 304, datë 14.02.2013 dhe nr. 354, datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatat më të larta”.

2. Vijimin e shqyrtimit të kërkesës për procedimin disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe dërgimin e akteve Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.11.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për z. {...}” (relatore znj. Fatmira Luli).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
3. ***Irena Plaku*** (anëtare)
4. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
5. ***Alban Toro*** (anëtar)*
6. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
7. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. ***Dritan Hallunaj***, ***znj. Brikena***

Ukperaj, z. Klodian Kurushi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. BIRN.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për z. {...}” (relatore znj. Fatmira Luli).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 5 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për z. {...}”, me relatorë znj. Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Zoti {...} është kandidat për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili ndihmës ligjor dhe është vlerësuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të vendimit nr. 157, datë 04.04.2023, se i plotëson kriteret për të marrë pjesë në Provimin e Pranimit në Programin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023–2024, profili “ndihmës ligjor”.

Kandidati ka marrë pjesë në provimin e organizuar dhe është përfshirë nga Shkolla e Magjistraturës, në listën e renditjes së kandidatëve fitues në Programin e Formimit Fillestar për ndihmës ligjor, viti akademik 2023–2024.

Në funksion të verifikimit në kohë të pasurisë dhe figurës, duke qenë se kjo

procedurë është e ndërvarur nga raportimet ka filluar sipas vendimit nr. 473, datë 07.09.2023, procedura e verifikimit të kandidatëve për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili ndihmës ligjor.

Në datën 07.09.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në ligj kandidati në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës; - për caktimin e relatores; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores. Po ashtu kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit.

Kandidati, në datë 11.09.2023 nëpërmjet postës elektronike ka bërë me dije tërheqjen nga vazhdimi i procedurave të mëtejshme në lidhje me pozicionin ndihmës ligjor, me arsyetimin se do të rikonkurroj përsëri në vitin akademik 2024-2025.

Me shkresën nr. 795 të Shkollës së Magjistraturës, datë 08.11.2023, ka informuar Këshillin se z. {...}, me kërkesën e tij, të depozituar me nr. {...} prot., datë 20.09.2023, ka kërkuar heqjen dorë nga e drejta për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar, duke dhënë edhe shkakun e kësaj dorëheqje për arsye se qëllimi i tij është të rikonkurroj përsëri në vitin akademik 2024-2025 për profilin magjistrat. Këtë veprim e ka bërë për shkak të dorëheqjes dhe nuk e ka arritur të lidh edhe marrëveshjen e regjistrimit me z. {...} Shkolla e Magjistraturës.

Vlerësimi mbi gjendjen e faktit (Znj. Luli parashtron që po i bie shkurtimisht për efekt kohe, pasi relacionin e kanë të tërë anëtarët).

Nga interpretimi i dispozitave ligjore, del e qartë se organi publik, i cili zhvillon procedurën, detyrohet të deklarojë përfundimin e saj, në rastin kur konstaton ekzistencën e njërit prej rasteve të parashikuara nga neni 95, i Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë dispozitë përdoren termat “pamundësia”, “objekti” dhe “qëllimi”, por, të cilat, duke u aplikuar në raste konkrete, qartësojnë vendimmarrjen e organit publik lidhur me vazhdimësinë e procedurave të filluara kryesisht nga ana e tij. Nga ana tjetër, duket i qartë interpretimi se qëllimi i procedurës bëhet i pamundur, në rastin kur kryerja e një veprimi administrativ, ka humbur aktualitetin, për shkak të ndryshimit të rrethanave, të cilat mund të jenë faktike ose ligjore.

Me heqjen dorë nga z. {...}, nga e drejta për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar, ka sjellë si pasojë rënien e shkakut për të cilin kjo procedurë ka filluar dhe për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i saj nuk ekziston më. Z. {...} nuk ka më statusin e kandidatit fitues, status për shkak të të cilit ka filluar nga ana e Këshillit procedura administrative e verifikimit.

Deklarimi i përfunduar i procedurës, nuk zgjidh themelin e çështjes, fakt i cili nuk pengon fillimin kryesisht të procedurës apo me kërkesë të palës së interesuar, në kuadër të një procedure tjetër, me objekt dhe qëllim të përcaktuar në ligj.

Sa më lart, vlerësohet se procedura e vlerësimit ndaj z. {...}, duhet të deklarohet e përfunduar, për arsye se z. {...} nuk gëzon më statusin e kandidatit fitues, cilësi dhe arsye mbi bazën e së cilës ka filluar procedura administrative e verifikimit nga ana e Këshillit, me vendimin e sipërcituar.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin, relatorja, në përputhje me kërkesat e vendimit 424/2020, ia parashtrroi çështjen Komisionit i cili vendosi në mbledhjen e datës 22.11.2023 duke e konsideruar procedurën e zhvilluar në përputhje me ligjin, bazuar në pikën 25, Seksioni C, Kreu IV, të Vendimit 424/2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës, për z. {...}, për shkak të humbjes prej tij të statusit të kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023–2024, profili ndihmës ligjor.

Edhe struktura e vendimit parashikon të njëjtën gjë. Në pikën e parë të këtij vendimi përcaktohet: Deklarimi i përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të z. {...}, të filluar me vendimin nr. 473, datë 07.09.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të humbjes të statusit të kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.

Pika 2, një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i

ndryshuar.

Pika 3, Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të mësipërm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Luli!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të z. {...}, të filluar me vendimin nr. 473, datë 07.09.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të humbjes të statusit të kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.

2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të

Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.11.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë Gjykatave të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, (relatore znj. Fatmira Luli).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|-------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 5. Alban Toro | (anëtar)* |
| 6. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e shtata sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. *Dritan Hallunaj, znj. Brikena Ukperaj, z. Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. BIRN.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë Gjykatave të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, (relatore znj. Fatmira Luli).

Ilir Rusi: Në vijim të këtij rendi dite të kësaj mbledhjeje, pika 6 duhet shqyrtuar me dyer të mbyllura për shkak të karakterit të saj. Kalojmë tek pika 7 e këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë Gjykatave të Apelit”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej fjalën relatores znj. Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Znj. {...} ka konkurruar në Shkollën e Magjistraturës në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Me vendimin nr.284, datë 25.05.2023, është kualifikuar dhe lejuar për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor.

Znj. {...} ka ndjekur programin e formimit fillestar për këtë vit akademik dhe me vendimin nr. 43, datë 16.10.2023, “Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për këshilltar dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023”, Shkolla e Magjistraturës e ka vlerësuar kandidaten znj. {...}, me 83.37 pikë.

Në kreun VII, të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të KLGJ-së, titulluar “Procedura e verifikimit të kandidatëve për në shërbimin civil gjyqësor” ndarë në 5 pika, ku në dy prej tyre, konkretisht pikat 93 deri në pikën 97 rregullohet mënyra sesi do të bëhet verifikimi për në shërbimin civil gjyqësor i kandidatëve që kanë përfunduar programin respektiv të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, duke iu nënshtruar verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Në këto dispozita, Këshilli ka përcaktuar se për kandidatët të cilët kanë ndjekur programin e formimit fillestar, do të pranohen në shërbimin civil nëse plotësojnë kushtin e kalimit me sukses të këtij programi në Shkollën e Magjistraturës. Pra verifikimi i pasurisë dhe i figurës ka mbaruar para pranimit të saj në Shkollën e Magjistraturës dhe në këtë moment është kushti formal, vërtetimi i faktit që ka mbaruar me sukses Shkollën e Magjistraturës.

Nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 23.10.2023, Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë vendimin e saj “Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për këshilltar dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023”, duke vendosur miratimin e listës së kandidatëve fitues, duke i renditur sipas pikëve që ata kanë marrë në vlerësimin përfundimtar në Programin e Formimit Fillestar.

Konform dispozita të vendimit nr. 424/2020, Këshilli ka përcaktuar se jo më vonë se dy javë nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të listës së kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për këshilltar/ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, disponohet në lidhje me kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit të tyre.

Për znj. {...} u verifikuan kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil

gjqësor, të përcaktuar në nenin 55, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, kushte të cilat përcaktohen si kritere të përgjithshme të pranimit në shërbimin civil edhe në nenin 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

Ato janë kushte të përgjithshme që ne i kemi referuar edhe në raste të tjera. Kështu që unë s’po ndalem në kushtet që ne kemi verifikuar në procedurën e mëparshme.

Për shkak të përmbushjes së tyre, Këshilli ka propozuar që zonja {...} plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civil gjyqësor në kategorinë ndihmës ligjor; është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, sipas vendimit të KLGJ-së nr. 284, datë 25.05.2023, “Për kualifikimin e kandidatës fituese për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor; ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës, e cila me vendimin e saj nr. 43, datë 16.10.2023, “Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për këshilltar dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023”, e ka vlerësuar kandidaten znj. {...}, me 83.37 pikë, pra mbi nivelin kualifikuar të pikëve të kësaj shkolle.

Për sa më sipër, çmoj se duhet të kualifikohet për vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Në Mbledhjen e datës 22.11.2023, Komisioni i Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, i propozoj atij që, bazuar në pikën 25, Seksioni C. 2, Kreu IV, të Vendimit 424/2020, të vendosë kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin dhe vijimin e procedurës për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, për pozicionin ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Luli!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë Gjykatave të Apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.11.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e këshilltarit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, (relatore znj. Fatmira Luli).²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|-------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 5. Alban Toro | (anëtar)* |
| 6. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare) |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e teta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. *Dritan Hallunaj, znj. Brikena Ukperaj, z. Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. BIRN.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e këshilltarit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, (relatore znj. Fatmira Luli).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 8 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e këshilltarit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej fjalën relatores znj. Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Znj. {...} ka ndjekur programin e formimit fillestar për këshilltar ligjor gjatë vitit akademik 2022-2023 në Shkollën e Magjistraturës.

Për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur me vendimin nr. 222, datë 08.05.2023, kualifikimin dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit

Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022, profili këshilltar ligjor.

Me vendimin nr. 138, datë 02.04.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konstatuar se znj. {...} plotësonte kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022. Me vendimin nr. 43, datë 16.10.2023, “Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për këshilltar dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023”, Shkolla e Magjistraturës e ka vlerësuar kandidaten znj. {...}, me 71.78 pikë, pra në nivelin kualifikues.

Në kreun VII, të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të KLGJ-së, titulluar “Procedura e verifikimit të kandidatëve për në shërbimin civil gjyqësor” ndarë në 5 pika, ku në dy prej tyre, konkretisht pikat 93 deri në pikën 97 rregullohet mënyra sesi do të bëhet verifikimi për në shërbimin civil gjyqësor i kandidatëve që kanë përfunduar programin respektiv të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, duke iu nënshtruar verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Në këto dispozita përcaktohet se për kandidatët të cilët kanë ndjekur programin e formimit fillestar, do të pranohen në shërbimin civil nëse plotësojnë kushtin e kalimit me sukses të këtij programi në Shkollën e Magjistraturës sepse kushtet e tjera për pasurinë dhe figurën janë verifikuar me vendimet e cituara më sipër.

Nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 23.10.2023, Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë vendimin e saj me “Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për këshilltar dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023”, duke vendosur miratimin e listës së kandidatëve fitues, duke i renditur ato sipas pikëve që ata kanë marrë në vlerësimin përfundimtar në Programin e Formimit Fillestar.

Konform dispozita të vendimit nr. 424/2020, Këshilli ka përcaktuar se jo më vonë se dy javë nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të listës së kandidatët që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për këshilltar/ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, disponohet në lidhje me kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit së tyre.

Për znj. {...} u verifikuan kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor dhe kriteret e posaçme që cituam më sipër për të cilat Këshilli ka vendime të mëparshme edhe për pasurinë dhe vendimin përfundimtar për kualifikimin me sukses të

Shkollës.

Për sa më sipër propozohet që zonja {...} plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civil gjyqësor në kategorinë këshilltar ligjor; së dyti, është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, sipas vendimit të KLGJ-së nr. 222, datë 08.05.2023; së treti, ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës, e cila me vendimin e saj nr. 43, e ka renditur në listën e kandidatëve fitues, me 71.78 % të pikëve.

Në këto kushte, Komisioni çmon se duhet të kualifikohet për emërimin dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Në mbledhjen e datës 22.11.2023, Komisioni i Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 25, Seksioni C, Kreu IV, të Vendimit 424/2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin për emërimin dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, për pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Projektvendimi parashikon në pikën 1 kualifikimin për emërim në shërbimin civil të znj. {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Pika 2. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

3. Efektet e juridike, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Luli!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin për emërim dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e këshilltarit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

2. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

3. Efektet e juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Në vijim të kësaj mbledhjeje, duke marrë në konsideratë rendin e ditës, pika e fundit e saj e cila ishte pika 6 por që do të shqyrtohet si pikë e fundit, për shkak të karakterit, do vazhdojë shqyrtimi i saj me dyer të mbyllura.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor